



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2020:130787

Datë: 21.11.2023

Numri i dokumentit: 05026171

C.nr. 4468/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “B...” me seli në Prishtinë, pa numër, tw cilwn sipas autorizimit e pwrfaqwson Kosovo “D...” me seli nw Prishtinw, kundër të paditurit M. (I.) R nga Obiliqi, , të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N. Rr avokat në Obiliq, në kontestin për rimbursim dëmi material dhe jomaterial, vlera e objektit të kontestit 1,600.00 euro, në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 08.11.2023 në prani të përfaqësuesve sipas autorizimit të palëve ndërgjyqëse dhe të paditurit personalisht, ndërsa me datë 21.11.2023 mori këtë:

AKTGJYKIM

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses “B...” me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri M. R nga nga Obiliqi, që paditëses t’ia rimbursoj shumë prej 1,600.00 euro, për dëmin e shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 30.12.2015 në Prizren, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e ushtrimit të padisë 09.10.2020 e deri tek pagesa definitive, si dhe t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. DETYROHET paditësja “B...” me seli në Prishtinë, që të paditurit M. R nga Obiliqi, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 426.00 euro në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja “B...” me seli në Prishtinë, me datë 09.10.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar padi kundër të paditurit M. R , nga Obiliqi, me objekt të padisë rimbursimin e dëmit në vlerë prej 1.600.00 euro. Paditësja në padi, ndër të tjera, ka theksuar se i padituri, më datë 30.12.2015, me automjetin O..., me targa të regjistrimit ..., ka shkaktuar aksident të trafikut në Prizren, ku si pasojë e këtij aksidenti janë shkaktuar dëme të dëmtuarit KS. A. Tutje, ka theksuar se i padituri, në momentin e aksidentit ka qenë pa mbulesë

siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, me ç'rast duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (LSDA) si dhe në respektim të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Byroja Kosovare e Sigurimeve i ka kompensuar të dëmtuarit dëmin e pësuar si rezultat i aksidentit.

Paditësja, përgjatë deklarimeve në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se i padituri në ditën e aksidentit po drejtonte veturën pa polisë valide të sigurimit, dhe ka shkaktuar aksident të trafikut, me ç'rast të dëmtuarit KS. A i ka shkaktuar dëme. Nga gjykata ka kërkuar që të obligohet i padituri që paditësen ta regresojë për dëmin që i është kompensuar palës së dëmtuar nga ky aksident, në bazë të marrëveshjes jashtëgjyqësore të lidhur nga paditësja dhe pala e dëmtuar, e që është sipas vlerës së kërkesëpadisë, në lartësi prej 1,600.00 euro. Paditësja, po ashtu, i ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjyqësore, dhe atë vlerën prej 20.00 euro në emër të taksës për padi.

I padituri M. R , në përgjigjen në padi të parashtruar pranë gjykatës me datë 09.08.2023, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Në përgjigje në padi ka theksuar se i padituri nuk ka shkaktuar aksident trafiku në Prizren, ndërsa vendi i shkaktimit të aksidentit të trafikut nuk është theksuar fare as në raportin e policisë me numër 2015-AC-1731, i datës 30.12.2015. Tutje në përgjigje në padi ka theksuar se paditësja padisë i ka bashkëngjitur edhe dy aktgjykime të Gjykatës së Apelit të Kosovës, por që të njëjtat nuk kanë të bëjnë me këtë rast, e as me të paditurin. Ndërsa në lidhje me procesverbalin për dëmet në automjet ka theksuar se të njëjtin e ka hartuar paditësja me datë 15.02.2017 vetëm duke u bazuar në fotot të cilat nuk dihet se kush i ka bërë. Në fund ka kërkuar nga gjykata që ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses.

I padituri M. R , përmes të autorizuarit të tij, në seanca gjyqësore ka deklaruar se nuk është i vërtetë pretendimi se i padituri ka shkaktuar aksident trafiku në qytetin e Prizrenit, ka theksuar gjithashtu se nuk është vërtetuar as fajësia e të paditurit në lidhje me aksidentin e shkaktuar. Ndërsa sa i përket aktgjykimeve të gjykatës së Apelit me numër Ae.nr. 298/16 i datës 26.02.2018 dhe aktgjykimi i gjykatës së Apelit me numër Ae.nr. 87/16 i datës 25.10.2017, ka theksuar se të njëjtat nuk kanë të bëjnë me të paditurin. Ndërsa në lidhje me lartësinë e dëmit të shkaktuar, ka theksuar se provat e bashkëngjitura në padi janë në tërësi kontradiktore me njëra tjetrën sa i përket konstatimit të dëmit, kjo për arsye se në vlerësimin e dëmit të datës 20.03.2017, ka vlerësuar se dëmi në automjet ka qenë 770.00 euro, kompania zvicrrane këtë dëm e ka vlerësuar në shumën prej 4,192.00 euro, ndërsa në ujdinë jashtëgjyqësore të cilën paditësja e ka bashkëngjitur si provë në padi, është shuma prej 20,603.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përpilimin e përgjigjes në padi, si dhe për pjesëmarrje në dy seanca gjyqësore.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat si në vijim: Raporti policor i aksidentit i datës 30.12.2015, me numër; Procesverbali mbi dëmtimin e automjetit me nr.201/17 i datës 15.02.2017; Urdhërtransferi bankar i datës 07.05.2019; Aktvlerësimi i dëmit i datës 20.03.2017; Marrëveshja jashtëgjyqësore e datës 02.05.2019; Aktgjykimi i gjykatës të Apelit Ac.nr.298/16, i datës 26.02.2018; Aktgjykimi

i gjykatës së Apelit C.nr.87/16, i datës 25.10.2017; Ujdia jashtëgjyqësore e datës 30.10.2018; Fatura e firmës Zvicerane G-C. G, nr.20160047, e datës 05.02.2016 dhe Marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të BKS dhe Kompanisë së Sigurimeve “I...”, e datës 30.10.2018.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Raporti policor i aksidentit me numër 215 AC-1731, i datës 30.12.2015, gjykata gjeti se me datë 30.12.2015, kishte ndodhur aksident i trafikut në mes të ngasësit të veturës së tipit O. dhe ngasësit të veturës së tipit A. , ndërsa në lidhje me raportin e detajuar të aksidentit është theksuar se do të nxirret raport i veçantë. Nga procesverbali mbi dëmtimin e automjetit me numër 201/17, i datës 15.02.2017, gjykata gjeti se paditësja ka bërë një vlerësim të dëmeve të shkaktuara në aksidentin e trafikut, ndërsa ky vlerësim është bërë në bazë të fotove. Nga urdhërtransferi bankar i datës 07.05.2019, gjykata gjeti se paditësja me datë 07.05.2019, ka transferuar shumën prej 1,600.00 euro në llogari të “I...” (për K.S “A...”). Nga aktvlerësimi i dëmit i datës 20.03.217, gjykata gjeti se është bërë llogaritja e dëmshpërblimit në vlerë prej 770.00 euro. Nga marrëveshja jashtëgjyqësore e datës 02.05.2019, gjykata gjeti se paditësja “B...” ka arritur ujdi jashtëgjyqësore me K.S “A...” – Zvicër, me anë të së cilës janë pajtuar që në emër të dëmit material “B...” – paditësja në këtë procedurë, t’ia paguaj K.S “A...” – Zvicër, shumë prej 1,400.00 euro, ndërsa në emër të shpenzimeve të procedurës, shumë prej 200.00 euro.

Gjykata vlerësoi edhe provat tjera të propozuara nga ndërgjyqësit siç janë: Aktgjykimi i gjykatës të Apelit Ac.nr.298/16, i datës 26.02.2018; Aktgjykimi i gjykatës së Apelit C.nr.87/16, i datës 25.10.2017; Ujdia jashtëgjyqësore e datës 30.10.2018; Fatura e firmës Zvicerane “G...”, nr.20160047 e datës 05.02.2016 dhe Marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të “B...” dhe Kompanisë së Sigurimeve “I...”, e datës 30.10.2018, por gjeti se këto prova nuk kanë të bëjnë me çështjen kontestimore objekt i kësaj procedure.

Për më tepër, në seancën përgatitore të datës 18.09.2023, gjykata duke vepruar konform nenit 356 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), lidhur me nenin 21 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka nxjerrë aktvendim me të cilin ka caktuar nxjerrjen e provës me anë të ekspertizës së komunikacionit. Në këtë rast, gjykata e ka obliguar paditësen që në afat prej 7 ditësh të paguaj kompensimin për ekspert në vlerë prej 150.00 euro, ndërsa dëshminë për këtë pagesë t’ia ofroj gjykatës. Paditësja nuk ka vepruar konform aktvendimit të gjykatës, në atë mënyrë që nuk ka bërë pagesën e shumës së përcaktuar për kompensimin e ekspertit, ndërsa gjykata ka konstatuar se e njëjta ka hequr dorë nga nxjerrja e provës me anë të ekspertizës së komunikacionit.

Mbi bazën e këtyre provave të administruara deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, gjykata me asnjë provë nuk arriti ta vërtetonte përgjegjësinë e të paditurit në lidhje me dëmin e shkaktuar në këtë aksident trafiku, gjykata erdhi në përfundim se paditësja “B...” me seli në Prishtinë, e ka kompensuar dëmin që është shkaktuar në një aksident trafiku të cilën paditësja ka theksuar që ka ndodhur në Prizren me datë 31.12.2015, e në lidhje me këtë dëm paditësja kishte kompensuar vlerën prej 1,600.00 euro.

Paditësja “B...”, me asnjë provë para gjykatës nuk arriti që të dëshmonte përgjegjësinë e të paditurit sa i përket shkaktimit të këtij aksidenti. Për më tepër, as në padi e as në seancat gjyqësore të mbajtura, paditësja nuk ofroi prova në lidhje me vendin e shkaktimit të aksidentit. Paditësja në kërkesëpadinë e saj, por edhe në seanca gjyqësore, regresin e mjeteve e kërkonte nga i padituri për shkak se i njëjti në momentin e shkaktimit të aksidentit ishte pa mbulesë siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, por që gjatë zhvillimit të kësaj procedure, para gjykatës nuk ofroi asnjë provë e cila do të dëshmonte mungesën e kësaj police apo konfirmimin se e njëjta ishte e skaduar. Gjykata vlerësoi raportin e aksidentit me numër ..., por që në të njëjtin nuk ishin dhënë detajet e aksidentit, në këtë raport është theksuar se do të hartohet raport i veçantë në lidhje me këtë aksident. Ndërsa nga ky raport gjykata nuk ishte në gjendje që të konstatonte përgjegjësinë e të paditurit në lidhje me shkaktimin e këtij aksidenti. Neni 319 paragrafi 1 i LPK-së ka përcaktuar se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit”*, ndërsa paragrafi 3 ka përcaktuar se *“Gjykata vendosë se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare”*.

Pra, pala paditëse deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, me asnjë provë nuk e ka argumentuar se përgjegjësia për regres të mjeteve i takon të paditurit për faktin se i njëjti ka qenë shkaktar i aksidentit dhe se në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguruese apo me policë të skaduar të sigurimit.

Me rastin e vendosjes, gjykata mori parasysh faktin se paditësja për të vërtetuar bazën e kërkesëpadisë gjykatës nuk i ka ofruar asnjë provë relevante në drejtim të vërtetimit të përgjegjësive për këtë aksident si dhe nuk ka propozuar asnjë provë në drejtim të vërtetimit të lartësisë së dëmit. Për më tepër paditësja nuk ka vepruar sipas aktvendimit të gjykatës me të cilin është obliguar që të paguaj kompensimin për nxjerrjen e ekspertizës së komunikacionit, nuk ka propozuar nxjerrje të provës me anë të ekspertizës së makinerisë për vërtetimin lartësisë së dëmit, por gjykatës i ka ofruar vetëm raportin e aksidentit e përpiluar nga ana e policisë, procesverbalin e paditësit për dëmtimin e automjetit, akt vlerësimin e dëmit të automjetit, fotografi, të gjitha këto prova të paditëses si dhe ujdise jashtëgjyqësore, regjistrin mbi transferin bankar nga paditësja për te i dëmtuari, e të cilat për këtë gjykatë nuk paraqesin prova të mjaftuara për ta vërtetuar bazën e kërkesëpadisë, përkatësisht fajësinë e të paditurit për këtë aksident dhe lartësinë e dëmit të shkaktuar, madje as mungesën e polisës siguruese apo polisën siguruese të skaduar ashtu siç ka pretenduar paditësja në padi dhe në seanca gjyqësore.

Në këto rrethana, me rastin e vendosjes gjykata mori për bazë edhe nenin 322 paragrafi 1 të LPK-së i cili ka përcaktuar se *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u bazuan në dispozitat e neneve 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-sw, si dhe në tarifën e avokateve të Kosovës, ashtu që u obligua paditësja që të paditurit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës shumën prej 426.00 euro, dhe atë në emër të përpilimit të përgjigjes në padi shumën prej 156.00 euro dhe për pjesëmarrje në dy seanca gjyqësore shumën prej 270.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.4468/20, datë 21.11.2023

Gjyqtarja
Qëndresa Beqiri Murati

KËSHILLË JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*